



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 061

KEC

Projekti i historisë së përbashkët

Tipi i programit: Bazik

Historiku i Programit

Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE), 14 vjet më parë, ndërmori një nismë që prezantoi një perspektivë gjithëpërfshirëse në historinë e Ballkanit nëpërmjet botimit të një seti prej katër librash, duke modernizuar mësimdhënien e historisë në Evropën Juglindore. Projekti implementohet në vende të ndryshme të Evropës Juglindore. Në Kosovë ky projekt implementohet që nga viti 2007 nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

“Projekti i Historisë së Përbashkët” (JHP) financuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet programit IPA, promovon pajtimin në vendet e Evropës Juglindore, me anë të mësimin të historisë në shkollat e rajonit. Ndër të tjera, ky projekt ofron trajnime për mësuesit, libra e materiale që plotësojnë kurrikulën kombëtare, duke nxitur mendimin kritik dhe debatin e lirë. Materialet edukative alternative - një përmbledhje e burimeve origjinale historike rreth katër temave të shquara në Evropën Juglindore: Perandorisë Osmane, Kombet dhe shtetet në Evropën Juglindore, Luftërat Ballkanike, dhe Lufta e Dytë Botërore janë pranuar gjerësisht në të gjithë shoqëritë e Evropës Juglindore. Deri tani, këto libra janë botuar në gjuhën Greke, Angleze, Serbe, Boshnjake, Kroate, Shqipe, Maqedonase, Bullgare, Turke dhe Malazeze. CDRSEE është e gatshme të ndërmarrë hapin tjetër përpara: botimi i dy vëllimeve të ardhshme: Evropa Juglindore në periudhën post-1945-dhe post-1989.

Arritjet dhe progresi

Librat aktuale, projektuar dhe redaktuar nga ekspertë e historianë të shquar në të gjithë rajonin, mbulojnë një periudhë të historisë daton nga shekulli 13-të deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Me më shumë se 1.000 mësues në rajon janë trajnuar lidhur me këto metodologji. Nder te tjera, librat kanë prekur jetën e mijëra nxënësve duke nxitur tek këta te menduarit lirshëm. Raporti i Monitorimit të BE kryer në prill 2012 e pranoi punën e shkëlqyer arritur deri tani nga JHP, sidomos në aspektin e qëndrueshmërisë së projektit,

efektivitetit, dhe ndikimin. Për më tepër, Parlamenti Evropian rekomandoi JHP në vitin 2009 për ndikimin e saj dhe efektivitetit (Parlamenti Evropian rezolutë të 24 prill 2009 në konsolidimin e stabilitetit dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor (2008/2200 (INI)),neni35).

Objektivat e programit

Të nxisë mësuesit e historisë në Evropën Juglindore të përdorin metodat moderne të mësimit dhe materialet me perspektive në klasat e tyre, duke bërë të mundur që ata të merren me ngjarjet e së kaluarës në klasë, në mënyrë që të shmangen modelet e mësimit të historisë në mënyrë etnocentrike dhe stereotipike.

Përmbajtja

Kurset e trajnimit do të zgjasin 2 ditë, do të drejtohen nga dy trajnues dhe do të moderohen nga një historian nga "Instituti i Historisë, Seminari organizohet në mënyrë të tillë që të marrin pjesë 25 mësues. Metodologjia e seminarit do të kalojë në këto faza: Fillimisht, mësuesit do të njihen me metodologjinë, objektivat e projektit dhe burimet e të mësuarit " Materialet Alternative të mësimit të historisë " e më pas do të njihen me strukturën e materialeve. Më pas, mësuesi do të jetë në gjendje për të diskutuar me trajnerët përfitimet nga metodologjia e re dhe me perspektive të mësimit të historisë. Trajnuesit do të japin shembuj se si metodologjia e re mund të përdoret për të pasuruar mësimin e historisë dhe në veçanti, trajnuesit do të shpjegojnë rolin e mësuesit, kur ai përdor metodologjinë e re dhe me perspektive, d.m.th. të qenit më tepër në rolin e një lehtësuesi sesa të një lektori. Trajnuesit pastaj do të angazhojnë mësuesit në punë në grup . Në këtë mënyrë, mësuesit do të shkëmbejnë përvoja të mënyrës së mësimit të historisë në klasa e më pas do shpjegojnë se si ata do të përdorin materialet mësimore alternative si një mjet për mësimit të historisë në perspektivë (kjo do të realizohet nëpërmjet mësimeve model, situata me role, etj.). Trajnuesit do të veprojnë si lehtësues, por mund të ndërhyjnë gjatë punës në grup nëse është e nevojshme. Më pas, mësimit model do të prezantohen nga mësuesit dhe do të diskutohen nga trajnuesit, d.m.th. përmbajtja metodologjike dhe sugjerime të ndryshme për përmirësime. Një fokus i veçantë do të vihet mbi zbatimin e metodologjisë në klasa me numër të madh nxënësish, në ato raste kur burimet janë të pamjaftueshme dhe në rastet me probleme të tjera lidhur me kontekstin lokal.

Grupi i synuar

Mësues të historisë të ciklit të ulet e të mesëm

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi organizohet në formë të një seminari 2 ditor dhe ka gjithsej 15 orë.

Vlerësimi/Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja në seminar, si dhe kryerja e detyrave që jepen gjatë trajnimit, përgatitja e mësimit model.

Materialet e Trajnimit

- Seti i librave: Mësimi i Historisë në Evropën Juglindore - Materialet alternative
- Udhëzuesi për shfrytëzimin e librave
- Të mësuarit për të mësuar – Një udhëzues për mësuesit e fokusuar te rezultatet.